



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 4.2.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROPOZIMIN E EKIPIT PËRZGJEDHËS “PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 – 36 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2019, mori në shqyrtim propozimin e Ekipit Përzgjedhës “Për emërimin e kryetarit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”.

Të pranishëm në mbledhje ishin dy kandidaturat e propozuara nga Ekipi Përzgjedhës, Z. Petrit AHMETI dhe Z. Agim NASHI.

- ***Baza ligjore***

Këto kandidatura paraqiten për shqyrtim bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 11 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar”.

Në bazë të pikës 7 të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni organizon seanca dëgjimore publike në të cilat kandidatët duhet të bëjnë një prezantim të vetes dhe punës së tyre përpara Komisionit.

- ***Qëllimi***

Kryetarit të Bordit të ERE-së i përfundon mandati me dt. 6.2.2019. Ekipi Përzgjedhës, në bazë të neni 11, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, me shkresën nr.3921/1 datë 28.12.2018 ka propozuar dy kandidatura për plotësimin e vakancës së krijuar në Bordin e ERE-s dhe konkretisht kandidaturën e Z. Petrit AHMETI i cili rikandidon dhe kandidaturën e Z. Agim NASHI.

Kandidatët e propozuar duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni 11, pika 5/a, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar.

Z.Ahmeti i cili kandidon për një mandat të dytë, ka përfunduar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në vitin 1980 dhe ka një karrierë mbi 30 vjeçare në fushën e energjisë. Ka punuar prej vitit 1981 në pozicione të ndryshme të rëndësishme të sektorit elektroenergetik ku më kryesoret vlen të përmendim detyrën e tanishme apo edhe si drejtues i Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH).

Ndërkohë, kandidati tjetër Z.Nashi ka përfunduar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në vitin 1970. Edhe Z.Nashi ka një karrierë mbi 30 vjeçare në fushën e energjisë duke punuar në pozicione të rëndësishme në këtë sektor si pranë KESH sha-së, Drejtor i Drejtorisë së Energjisë në Ministrinë e Energjitikës, Kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe si drejtor në këtë Ent.

- ***Diskutimi në komision***

Komisioni u njoh me CV-të dhe me mendimet e kandidatëve në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë të ERE-së në sektorin e energjisë.

Kandidatët e përzgjedhur paraprakisht nga Ekipi Përzgjedhës, Z. Petrit AHMETI dhe Z.Agim NASHI bënë një prezantim të shkurtër të eksperiencave të tyre, si dhe një panoramë të sektorit të energjisë dhe sfidave të tij. Gjithashtu, ata iu përgjigjën interesit të deputetëve në lidhje me çështje të ndryshme që lidhen me sektorin e me zhvillimin e investimeve në sektor.

Të dy kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni 11, pika 5/a, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi se kandidaturat e propozuara nga Ekipi Përzgjedhës janë në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Andrea MARTO

Niko PELESHI

Relatori

Kryetari